



PERMBLEDHJE JOTEKNIKE

FIONA 2006

Subjekti fizik “Fjona-2006 ” i regjistruar ne QKR si person juridik me NIPT. K31321510F me seli ne Durres Xhafzotaj RRETH Zona Kadastrale 3225, Godine private me nr. pasurie 48/92, Kati I-re, kerkon te pajiset me Leje Mjedisore Tipi B per aktivitetin: Menaxhimi i mbetjeve; pika 5.4.c. Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme. Aktiviteti do te ushtrohet ne Durres, Rreth, Zona kadastrale 3225, Numer pasurie 132/75. Vendodhja e aktivitetit do te jete si me poshte:



Koordinatat e tij do te jene



Pika	Zona	X	Y
1	4	4378027.92	4578280.65
2	4	4378044.16	4578284.85
3	4	4378031.52	4578334.30
4	4	4378018.90	4578331.82

Koordinatat Gauss - Kruger te aktivitetit

Pamje nga vendi ku do te ushtrohet aktiviteti



Riciklimi është procesimi i materialeve të përdorura në produkte të reja, në mënyrë që të reduktojë shpërdorimin e materialeve të dobishme.

Rikuperimi është procesi i ripërpunimit të mbeturinave. Kohët e fundit ky proces ka një zhvillim të gjere në shumë fusha industriale: të hekurit, drurit, plastikës, të qelqit (për të përmendur këtu me të rëndësishmet). Për të bërë sa më të thjeshtë këtë proces dhe ripërfitim të materialeve të riciklueshme është vënë në funksion grumbullimi i diferencuar i mbeturinave në kontejneret përkatës: leter, qelq, plastike apo mbetjet

e njoma (qe jane mbetjet ushqimore). Riciklimi i mbeturinave ndihmon planetin tone. Grumbullimi i mbeturinave sjell nje mjedis me te paster per ne e femijet tane, kurse riciklimi i tyre mbron burimet e pasurite natyrore qe te mos shteren kurre. Riperdorimi, Reduktimi, Riciklimi jane 3 fjalet me te rendesishme qe ndihmojne natyren dhe mjedisin ku jetojme. ndryshe te quajtura 3R (nga angl. Reduce, Recycle, Reuse. nga ital. Ridurre, Ricilare, Riutilizzare). Riciklimi behet i mundur fale ndihmes tone. Jemi ne ata qe duhet te diferencojme fillimisht mbeturinat qe prodhojme. Per te bere nje grumbullim te diferencuar sa me efektiv, eshte e rendesishme te njohim cilat jane materialet e riciklueshme dhe si duhet ti ndajme ato. Riciklimi i letres hap pas hapi 1- Mblidhen mbetjet e letres nga vendgrumbullimet e mbetjeve. 2- Letra futet ne kazana me uje. 3- Ndahen fibrat e letres nga mbetjet e tjera si boje, papasterti etj. 4- Lenda e formuar thahet dhe i jepet forme duke e presuar. 5- Formohet keshtu letra e re e gatshme per perdorim Letra nuk mund te riciklohet deri ne pafundesi. Fibrat e letres pas cdo riciklimi vine e shkurtohen duke ulur keshtu cilesine e letres. P:SH Nje kuti kartoni mund te riciklohet deri ne gjashte here.

BE ka krijuar nje sistem te mbikëqyrjes dhe kontrollit te çdo lëvizjeje të mbeturinave brenda kufijve të vendeve anëtare, me vendet e Eftas, (Shoqatës europiane të tregtisë së lirë), me organizatën e OECD si dhe vendet e treta që janë palë Kontraktuese të Konventës së Bazelit.

Me fjalën “riciklim të mbetjeve” kuptohen një sërë strategjish, me qëllim rikuperimin e materialeve nga mbetjet për t’i ripërdorur ato dhe jo për t’i asgjësuar. Riciklimi parandalon shpërdorimin e materialeve potencialisht të dobishme, redukton konsumin e lëndëve të para, përdorimin e energjisë elektrike dhe rrjedhimisht emetimin e gazit serë. Materialet që përdoren për riciklim janë të gjitha mbeturinat që me anë të këtij procesi mund të ripërdoren për të prodhuar objekte të reja. Lëndët e para që mund të riciklohen janë druri, qelqi, letra dhe kartoni, alumini, gomat, plastikat dhe pëlhurat.

Pershkrim i procesit. Rekuperimi i mbejeteve per riciklim dhe stacion transferimi per mbetje jo te rrezikshme

Procesi i punes eshte teresisht mekanik. Duhet te theksojme qe ne fillim se ne kete veprimtari nuk do te kete asnje lloj nderveprimi apo reaksioni kimik gjate proceseve te punes. Nuk do te kete asnje lloj procesi energjitik apo djegie. Te gjitha operacionet do te jene manuale, duke nisur ng vecimi i metjeve ne kategorite kryesore: leter – karton, qelq, alumin, plastike, mbetje organike te biodegradueshme. Po ne menyre mekanike kategorite e mbetjeve te seleksionuara do te presohen per te kursyer vend dhe vellim. Me tej do te behet transporti i rrymave te seleksionuara te mbetjeve drejt perpunuesve apo ricikluesve te tjera apo pikave te metejshme te trajtimit. Nuk do te kete pra clirime te gazta apo te lengeta si rrjedhoje e procesit te punes.

Mbetjet e grumbulluar nga operatori Fjona - 2006 nga subjektet me te cilet kompania ka lidhur kontrata te rregullta sherbimi, do te sillen ne kete pike rekuperimi te mbetjeve urbane. Te gjitha mbetjet jane mbetje urbane.



NDARJET E MBETURINAVE SIPAS PERBERJES.

Mbeturinat urbane kryesore përfshijnë këta përbërës: qelqin, letrën, plastikën, gomën, metalet me natyrë hekuri ose jo, kartonët, pajisjet elektrike, mbeturinat organike etj. Qelqi - Si burim i mbeturinave shtëpiake ai mund të vijë nga xhamat, por kryesisht nga kavanozët, shishet për një përdorim apo të ripërdorshme të pijeve etj. Kjo lëndë e parë ricikluese mund të riciklohet dhe të ripërdoret qindra herë. Letra - Letra vjen nga paketimet, gazetatat, letrat për zyrë, posta etj. Gazeta tradicionalisht riciklohet dhe bëhet karton apo prape gazetë. Letra për zyrë riciklohet dhe kthehen në letër higjenike. Mbeturinat e letrës mund të riciklohen dhe të shndërrohen në letër të re, por gjithashtu mund të shndërrohen në material izolues të zërit. Metalet - prodhimet nga hekuri, çeliku të cilat shkrihen dhe ripërdoren në industrinë e rëndë. Shishet “PET-it” (qe përdoren për ambalazhim lengjesh ushqimore) mund të riciklohen dhe të shndërrohen në topa tenisi apo qilima. Gomat e përdorura- mund të riciklohen dhe shndërrohen në material për qilima dhe të përdoret në asfalt. Mbeturinat organike- mund të kompostohen dhe përdoren si pleh natyral për kopshte. Prodhimet e aluminit si: kanaçet e pijeve etj- janë produkte që mund të kursejnë shumë energji nëse riciklohen. Kursimi i energjisë dhe mbrojtja mjedisore si dhe përparësitë tjera ekonomike dhe mjedisore janë shumë të mëdha kur alumini riciklohet.